



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 29-të e radhes (e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 24. 05. 2016 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰)

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Daut Azemi, anëtar
5. Agron Hajdini, anëtar
6. Arton Retkoceri, anëtar
7. Naim Jahiri, anëtar
8. Burbuqe Fazliu, anëtar
9. Linda Shahini, anëtar
10. Xhevat Olluri, anëtar
11. Rizah Bajraktari, anëtar
12. Ukë Kryeziu, anëtar
13. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
14. Hajrije Salihu, anëtar
15. Blerim Gashi, anëtar
16. Adelina Krasniqi, anëtar
17. Florent Hoxha, anëtar
18. Petrit Kelmendi, anëtar
19. Lulzim Rrustemi, anëtar
20. Nazmi Krasniqi, anëtar
21. Feriz Hasani, anëtar
22. Ali Stublla, anëtar
23. Valbona Shillova, anëtar
24. Burbuqe Ilazi, anëtar
25. Vlora Buja, anëtar
26. Arben Bahtiri, anëtar
27. Edita Gashi, anëtar
28. Ramiz Qeriqi, anëtar
29. Zoran Çirkovic, anëtar
30. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Sefer Tasholli, Nënkryetar i Komunës

3. Shaban Syla, Shef i sektorit për buxhet
4. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit
5. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
6. Remzi Mehmeti, Drejtor i DSHM
7. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-së
8. Heset Sahiti, Drejtor i DSHP
9. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
10. Ahmet Maksuti, zyra ligjore
11. Bukurie Zejnullahu-Jashari, zyrtare për informim
12. Bekim Krasniqi, "YAHR"
13. Përfaqësues të OJQ "POLIS" (1)
14. Përfaqësuesit e mediave
15. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
16. Bajram Zaskoku, përkthyes shqip-serbisht
17. Haki Avdiu , operator i zërimit

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj njoftoi se kjo mbledhje është e jashtëzakonshme dhe kemi vetëm një pikë të rendit të ditës; propozim vendimin mbi rishikimin e buxhetit për vitin 2016. Pastaj vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi unanimisht për punën e kësaj mbledhje aprovoi këtë:

REND DITE

1. Propozimi i Vendimit mbi rishikimin e buxhetit për vitin 2016

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit në mungesë të Drejtorit për Buxhet dhe Financa i dha fjalën Shaban Sylës, shef i sektorit për buxhet i cili fillimisht tha se kjo mbledhje është thirrë e jashtëzakonshme pa fajin tonë meqë nga Ministria na kanë dërgu një shkresë me 18. 05. 2016 për rishikim të buxhetit. Në vazhdim tha se instruksioni që ka ardhur nga Ministria neve na kufizon mjaft shumë meqë Ministria ka kërku që ta njoftojmë vetëm ku kemi kursime dhe ajo t'i orientoj fondet ku kemi obligime të prioriteteve por na në këtë propozim kemi parapa edhe projekte të reja. Në vazhdim njoftoi me të dhënat nga rishikimi i buxhetit në kategorit e investimeve kapitale, mallra dhe shërbime komunale si dhe paga dhe medijtje të cilat kapin shumën prej 677,190.55€ duke njoftuar se kjo shumë do të ndryshohet dhe zbritet për 58.334,07€ për shkak se këto mjete janë hjekë nga thesari në emër të borxhit kështu që nga fondi burimor 10 shuma e planifikuar prej 520,779.08€ zbritet në 462.445,01€ kështu që shuma e përgjithëshme e paraparë nga fondi burimor 10 dhe fondi burimor 21 do të jetë 618.856,48€. Në vazhdim tha se te kodi 40209 te ndërtimi i Qendrës Rinore në Magurë faza e dytë shuma e parë prej 177,321.40€ zvogëlohet në 118.986,93€ dhe te kodi 87259 ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Bujari shuma e paraparë prej 100 mijë euro zbritet në 41.665.53€.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, sipas propozimit të Vendimit në bazë të asaj që e ceku Shabani shihet se shuma e përgjithëshme ka ndryshime për shkak të hjekjes së mjeteve nga thesari në emër të borxhit, mirëpo sipas vendimit shihet se te shumica e projekteve të planifikuara ka tepricë të mjeteve dhe konsideroj se rishikimi i këtyre mjeteve është gjithë përfshirës për tërë territorin e komunës duke filluar nga Janjeva e deri në Shalë me rrethin. Në vazhdim tha se është mirë që asnjëherë nuk po krijohen borxhet dhe borxhi që është trashëguar nga qeveria e kaluar dukshëm është zvogëluar.

Ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim vendime me ndryshimet që i ceku Shabani.

Blerim Gashi, është kriju një praktikë që rishikimi i buxhetit qdo herë po vjenë në mënyrë urgjente dhe ne anëtarët e Kuvendit e kemi të pa mundëshme për propozime. Është e vërtetë që nga planifikimi i projekteve po mbesin mjete.

Nga mallërat dhe shërbimet po shihet se janë tërënjë mjete mirëpo në shkollat e mesme gjendja nuk është e mirë dhe ka nevojë që të intervenohet te këto shkolla e nuk e di pse janë tërënjë 10 mijë euro. Pastaj njoftoi lidhur me shpenzimet që krijohen në shkollë për përgaditjen e testeve për nxënës. Në fund tha se si grup parlamentar e përkrahim këtë rishikim të buxhetit.

Florent Hoxha, e përmendi edhe parafolësi se materiali për këtë pikë na ka ardhur dje e gjithashtu edhe shefi i sektorit e tha se kjo po ndodh qdo herë në mënyrë urgjente që sipas mendimit tim nuk është në rregull. Në vazhdim tha se sipas mendimit tim planifikimi për projekte nuk është në rregull si shembull po e marr ku kemi projekt që janë planifiku 50 mirë euro a pas përfundimit të projektit teprojnë 25 mijë euro e që jep me kuptu se diqka nuk është në rregull.

Te projekti i Sitnicës janë të parapara 220 mijë euro a kompanitë kanë konkuru edhe me 73 mijë euro dhe kjo nuk është normale dhe me këtë shumë të mjeteve normalisht se nuk do të ketë kualitet të punës.

Me këtë Vendim apo rishikim të buxhetit janë paraparë projekte të reja mirëpo është pikë pyetje se me rishikim a do t'i pranon Ministria këto projekte. Te sheshi "Adem Jashari" e di se te ky projekt është bërë një ndryshim e ndoshta Kryetari do të na njoftoj se qka parashihet në sheshin "Adem Jashari". Për Topliqan për asfalimin e rrugëve janë paraparë 35 mijë euro dhe nuk e di se a mund të kryhen të gjitha rrugët. Për rrugën Shalë – Baicë janë parapa 41 mijë euro dhe unë konsideroj se nuk mjaftojnë këto mjete dhe kërkoj që kjo rrugë të jetë e gjërë 4 metra.

Për fshatin Divlakë kemi kërku disa herë që të hynë në prioritet por gjerë më tani nuk është parapa, andaj propozoj që me këtë rishikim të parashihet rruga për Divlakë.

Ukë Kryeziu, edhe ne si grup parlamentar i AAK-së ju njoftoj se nuk e kemi analizu sa duhet për shkak të afatit të shkurtur, por pa u futur në analizë u sygjeroj që së pari të përfundojnë projektet që kanë mbetur pa u kryer e pastaj projektet e reja. Ne si grup parlamentar i AAK-së e përkrahim këtë rishikim të buxhetit me sygjerimin që e ceka më lartë.

Petrit Kelmendi, unë po i përgjigjem Blerimit në pyetjen për shkollën dhe ju noftoj se shkolla është e gatshme për t'u përruar por do të shohim se kur do të hynë në agjend nga Kryetari. Pastaj tha se në shkollën "Vëllëzërit Frashëri" së shpejti do të bëhet inventarizimi i sallës dhe vlera është 50 mijë euro. Sa i përket rishikimit të buxhetit ky Vendim është në kundërshtim me udhëzimin që ka ardhur nga Ministria e Financave. Unë mendoj se sot duhet t'i kemi dy propozime ku njëri propozim të jetë që e lejon Ministria e Financave kurse propozimi i dytë t'i parasheh nevojat që ka komuna dhe këtë po e them në mënyrë që mos të vijmë para aktit të kryer se nëse propozimin e këtij vendimi nuk e pranon Ministria atëherë të kemi propozimin e gatshëm që e nxjerrim sot meqë ju si Kryesuese nëse

nuk kalon ky vendim në Ministri dot të detyrohesh me thirr një mbledhje tjetër të radhës ose me bërë ndryshim në Vendim.

Ramiz Qeriqi, kërkesa ime është që te sheshi “Adem Jashari” të dijmë se qka parashihet për rregullimin e sheshit, ndërsa këto mjete që kanë mbetë nga realizimi i projekteve konsideroj se këto janë rezultat i asaj që punët nuk janë kryer në mënyrë kualitative dhe si duhet.

Lulzim Rrustemi, buxheti i propozuar është dashtë paraprakisht të shqyrtohet në KPF meqë është obligim ligjor.

Projekti për sheshin “Adem Jashari” është aprovu në Kuvend dhe nuk ka mund të ndryshohet pa kalu përsëri në Kuvend.

Projekti për rrugën për Divjakë që është kërkesë qe 3 vite është dashtë të hynë në këtë rishikim dhe mos të anashkalohet.

Te Rufci i Vjetër është shtru një pjesë e trotuarit por nuk e di se a ka përfundu tërsisht meqë këtu kanë tepru mjete.

Te Jeta e re nuk kemi asnjë projekt e gjithashtu te lagja e Akllapit ka fillu asfaltimi i rrugës dhe nuk e dijë a ka përfundu. Në disa fshatra kemi planifiku trotuare a në anën tjetër kemi fshatra që ende nuk e kanë rrugën kjo nuk është në rregull.

Ali Stublla, tha se unë po e shoh që Kryetari e ka harru tërësisht Jetën e Re.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, unë dëgjova propozimet dhe shqetësimet e juaja. Na me urgjencë kemi propozu rishikimin e buxhetit dhe nëse ky variant nuk kalon na kemi mundësi që deri me 3 qershor të ftojme edhe një mbledhje tjetër meqë deri me këtë datë është shty afati i dërgimit të rishiqimit të buxhetit. Në vazhdim tha se na kemi kalu me mjete prej një programi në tjetër dhe në vazhdim përmendi projektin për kanalizim Rubovc, shkollën në Bujari, sallën në Llugaxhi etj.

Për Jetën e re kemi në planifikim hapjen e rrugës për varreza mirëpo aty janë prona private dhe për shtruarjen e kësaj rruge duhen 200 mijë euro që për momentin nuk i kemi.

Në vazhdim tha se nuk është vetëm rruga e Divjakës por kemi edhe shumë fshatra që janë pa rrugë. Në vazhdim përmendi problemet për kanalizimet në Rubovc te Vogël, Rubovc të Madh e gjithashtu edhe për Lipjan. Pastaj tha se të gjithë e dijmë se nevojat janë shumë më të mëdhaja se sa mundësitë dhe askush nuk mundet me qenë ideal por nëse mbi 50% është mirë duhet të pajtohemi. Në Krojmir janë dy lagje që duhet shtruar rruga e gjithashtu edhe në Shalë rruga e Karpuzëve. Rruga Shalë-Baincë është planifiku 4 metra që këtë e kërkoj edhe Florenti.

Te sheshi “Adem Jashari” kemi pasur debat publik dy herë dhe na do të bëjmë ndërtimin e rrugës dhe nga DEMOSI presim 100 mijë euro por për këto 100 mijë euro kemi kusht që na të kryejmë fazën e parë deri me 1 gusht. Unë me mirëkuptim ju lus që ta aprovoni këtë rishikim të buxhetit dhe te kioska mjetet e parapara në Administratë propozoj që të qiten në Shërbime Publike .

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesja vuri në votim propozimin e vendimit për rishikimin e buxhetit me propozimin e Shabanit për ndryshimet që i përmendi më lartë si dhe me propozimin e Kryetarit që mjetet për kioskë të propozuara në administratë të bartën në Shërbime Publike dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, kundër nuk pati 1 apstenim, Kuvendi miratoi këtë:

Pasi qështje tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 11,¹⁰